



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1367 prot.

Tiranë, më 08. 10. 2020

V E N D I M

Nr. 133, datë 08. 10. 2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 17, datë 05.03.2020, e shtetasit A. C., kundër Policisë Bashkiake Tiranë, në të cilën pretendohet për diskriminim *për shkak të racës, etnisë dhe gjendjes ekonomike*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

A. C. në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka sqaruar se më datë 03.03.2020, rreth orës 12:00, është ndaluar në Bulevardin “Zogu I”, nga ana e punonjësve të Policisë Bashkiake Tiranë, për shkak se ka qënë duke transportuar disa mbetje të riciklueshme (hekur), me mjetin e tij të llojit biçikletë me tre rrota, drejtë një pike grumbullimi pranë zonës së Stacionit të Trenit në Tiranë. Sipas tij, nga ana e 2 (dy) punonjësve të Policisë Bashkiake, i është sekuestruar mjeti biçikletë, si dhe materialet e vendosura në të, pa i dhënë asnjë dokument zyrtar apo akt administrativ lidhur me veprimet e ndërmarra prej tyre. Në përfundim, ankuesi ka pretenduar se është diskriminuar nga ana e punonjësve të Policisë Bashkiake Tiranë, për shkak të racës, etnisë dhe gjendjes ekonomike, pasi të gjitha veprimet e kryera prej tyre janë në shkelje të legjislacionit për Policinë Bashkiake.

¹Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Në zbatim të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, A. C. ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të marrë masa për shqyrtimin e ankesës dhe konstatimin e diskriminimit nga ana e strukturave të Policisë Bashkiake Tiranë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimoreose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Pas analizimit paraprak të ankesës sipërcituar, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonin kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 403/1 prot., datë 11.03.2020 nga ana e KMD i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues² Policisë Bashkiake Tiranë, lidhur me pretendimet e ankuesit.

Në përgjigje përsa më sipër, Policia Bashkiake Tiranë, me anë të shkresës³ nr. 11006/1 prot., datë 27.04.2020, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “...në datën 03.03.2020, Shërbimet e Policisë Bashkiake pasi kanë marrë njoftimin për persona të cilët grumbullonin materiale të riciklueshme nga kontenierët e mbetjeve urbane, në Blv. ‘Zogu I’, Njësia Administrative Nr. 9, kanë konstatuar shtetasin A. C., i cili kishte mbledhur materiale të riciklueshme në kontenierët e mbetjeve urbane të Bashkisë Tiranë. Përsa më lart, referuar ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996, neni 2 ‘Të gjitha llojet e mbetjeve, sipas përcaktimit të bërë në këtë ligj, pas dorëzimit të tyre janë pronë shtetërore’, materialet e riciklueshme u bllokuan dhe u dërguan në Landfilldin e Tiranës. Përsa i përket diskriminimit të pretenduar nga shtetasi A. C., sqarojmë se shërbimet e Policisë Bashkiake në asnjë moment nuk kanë përdorur dhunë dhe/apo diskriminim racor ndaj shtetasit në fjalë”.

² Është kërkuar konkretisht:

- Informacion mbi pretendimet e ngritura në ankesë nga ana e A. C.
- Informacion dhe kopje të dokumentacionit lidhur me veprimet e kryera nga ana e punonjësve të Policisë Bashkiake Tiranë, për bllokimin materialeve dhe mjetit biçikletë të ankuesit.
- Si dhe çdo shpjegim apo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

³ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 403/2 prot., datë 29.04.2020

2. Në vijim, nëpërmjet shkresës⁴ me nr. 430/3 prot., datë 11.05.2020, Komisioneri iu drejtua sërish Policisë Bashkiake Tiranë, duke i kërkuar informacion shtesë lidhur me sqarimin e plotë të çështjes.

Nëpërmjet shkresës⁵ nr. 11006/3 prot., datë 18.05.2020, Policia Bashkiake Tiranë, ka informuar Komisionerin ndër të tjera se: *“...në lidhje me dokumentacionin për veprimet e kryera, sqarojmë se në të gjitha rastet, ku konstatohet mbetje urbane brenda dhe/apo jashtë kontenierëve të mbetjeve urbane, ato dërgohen në Landfilldin e Tiranës nga kompanitë e pastrimit dhe ndërmarrjet e pastrimit të Bashkisë Tiranë dhe jo nga ana e Policisë Bashkiake. Thënë kjo, në rastet kur shtetasit nuk paraqesin ndonjë dokument, i cili vërteton pronësinë, Policia Bashkiake nuk mban dokumentacion për dërgimin e mbetjeve në vend grumbullimin e caktuar me ligj. Problemi i sipërpërmendur është fenomen i cili lidhet me papërgjegjshmërinë e shtetasve të ndryshëm në disa raste, por dhe me konsumimin e veprave penale, për të cilët Policia Bashkiake ka bërë kallëzimet përkatëse pranë Policisë së Shtetit. Pasi selektimi dhe marrja e mbetjeve urbane, pronë e Bashkisë Tiranë, konsumohet vepër penale...”*

3. Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhrin nr. 60, datë 27.05.2020 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, *“Për kryerjen e inspektimit pranë Policisë Bashkiake Tiranë, me qëllim marrjen e informacionit, lidhur me ankesën e shtetasit A. C.”*, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, më datë 02.06.2020, për të marrë informacion dhe për të kryer verifikimet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

Gjatë inspektimit të kryer, inspektorët e KMD-së morën takim me përfaqësuesin e Policisë Bashkiake Tiranë, konkretisht me shtetasin T. B., me detyrë Shef i Sektorit të Kontrollit të Territorit të Policisë Bashkiake Tiranë.

Lidhur me rastin konkret nga ana e përfaqësuesit të Policisë Bashkiake Tiranë u sqarua ndër të tjera se: *“...në sallën operative të Policisë Bashkiake, ka mbërritur një informacion lidhur me një shtetas i cili ka ndërhyrë në kontenierët pronë e Bashkisë Tiranë, duke marrë materiale të riciklueshme. Nga patrulla e Policisë Bashkiake është konstatuar në Bulevardin ‘Zogu I’, një person duke transportuar mbetje urbane me një mjet biçikletë (tre rotak). Në atë moment është ndaluar ky person nga ana e patrullës së Policisë Bashkiake, pa e ditur identitetin e tij apo përkatësinë etnike dhe më pas është njoftuar Drejtoria e Pastrim Gjelbërimit të Bashkisë Tiranë për tu ardhur në ndihmë të patrullës. Duke qënë se referuar legjislacionit përkatës, mbetjet urbane janë pronë e Bashkisë Tiranë, nga ana e strukturave të Drejtorisë së Pastrim Gjelbërimit,*

⁴ Informacion dhe kopje të dokumentacionit lidhur me veprimet e kryera nga ana e punonjësve të Policisë Bashkiake Tiranë, për bllokimin materialeve dhe mjetit biçikletë të ankuesit. (Kopje të procesverbalit të bllokimit materialeve dhe mjetit biçikletë të ankuesit, akt-konstatime apo çdo dokument tjetër që është mbajtur gjatë procedurës së ndjekur nga ana e Policisë Bashkiake Tiranë.)

⁵ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 403/4 prot., datë 20.05.2020

është bërë transportimi drejtë Landfilldit të Tiranës. Së bashku me mbetjet është bërë transportimi i mjetit biçikletë (karocë), pasi shtetasi nuk dispononte asnjë dokument pronësie mbi të. Në të gjitha rastet kur konstatohet një person që ndërhyr në kontenerët e mbetjeve urbane ose në afërsi të tyre, për faktin se përbëjnë vepër penale, i merren së bashku me mbetjet dërgohen në Landfilldin e Tiranës. Edhe në rastin që shtetasit e ndaluar nuk disponojnë asnjë dokument pronësie mbi biçikletat e modifikuara, së bashku me mbetjet urbane i merret edhe mjete i transportit. Në rastet që Policia Bashkiake konstaton individ të cilët nuk janë përsëritës, këshillohen nga punonjësit tanë dhe i bëhet vetëm bllokimi i materialeve të riciklueshme. Në rastet kur konsiderohen përsëritës, veç mbetjeve i bllokohen edhe biçikletat apo mjetet e modifikuara për të cilat nuk kanë akt pronësie. Përgjatë periudhës 01.01.2020 deri më sot, nga ana e strukturave të Policisë Bashkiake janë konstatuar dhe është ndjekur e njëjta procedurë si në rastin e ankuesit, pa marrë parasyshë përkatësinë etnike, racën, gjininë apo çdo shkak tjetër. Në pjesën më të madhe të rasteve, si në rastin e ankuesit, Policia Bashkiake paraqet kallëzim penal pranë organit të Prokurorisë.”

Në mbështetje të informacionit të sipërcituar, nga ana e përfaqësuesit të Policisë Bashkiake Tiranë u vu në dispozicion të inspektorëve të KMD-së:

- Korrespondenca e mbajtur me ankuesin;
- Raporti i Shërbimit të mbajtur në momentin e bllokimit të mbetjeve dhe karrocës së ankuesit;
- Informacion shtesë lidhur me veprimet e Policisë Bashkiake edhe për raste të ngjashme;
- Planin e Masave të Përbashkët mes Bashkisë Tiranë, Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, Drejtorisë Rajonale të Hetimit Tatimor Tiranë, Drejtorisë Rajonale të Mjedisit Tiranë dhe Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave.

4. Për administrimin e plotë të informacionit të kërkuar, për një gjykim sa më të drejtë dhe objektiv të çështjes, si dhe në zbatim të parimit të barazisë për një proces të rregullt ligjor, Komisioneri vlerësoi të nevojshme realizimin e seancës dëgjimore mes palëve. Në këtë kuptim me anë të shkresës Nr. 745 prot., datë 16.06.2020, Komisioneri njoftoi palët lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore më datë **26.06.2020, ora 10:00**.

Me anë të shkresës Nr. 745 prot., datë 16.06.2020, nga ana e Komisionerit u kërkuar që, ditën e zhvillimit të seancës dëgjimore palët të japin shpjegime dhe kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Informacion nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, nëse është kryer ndonjë studim mbi pozicionin e grumbulluesve individualë romë dhe egjiptianë të mbetjeve të riciklueshme në kontekstin e dhënies me konçension të hapësirave të grumbullimit të mbetjeve. Nëse po, një kopje të studimit të kryer.

- Informacion nga ana e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, nëse është kryer ndonjë kontroll i zbatimit dhe rishikimi i rregulloreve ekzistuese për trajtimin e mbetjeve që të garantohet që të gjitha impiantet për trajtimin e tyre të jenë të rrethuara, në mënyrë që të parandalohet aktiviteti i rrezikshëm i grumbullimit të mbetjeve nga këto impiante, veçanërisht nga fëmijët. Nëse po, një kopje të informacionit të përfutur.
- Informacion nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, nëse është zhvilluar program subvencionimi për përmirësimin ose zëvendësimin e automjeteve të modifikuara që përdoren nga romët dhe egjiptianët për transportin e mallrave, për të përmirësuar sigurinë publike dhe për të siguruar të ardhura më të qëndrueshme. Nëse po, një kopje të informacionit të përfutur.
- Informacion nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale dhe Bashkisë Tiranë, nëse janë zhvilluar aktivitete avokuese me përfaqësues të qeverisjes vendore për të ulur taksat dhe tarifat vendore me 30 për qind për bizneset e ngritura nga romë dhe egjiptianë. Nëse po, një kopje të informacionit të përfutur.
- Informacion lidhur me masat e marra nga ana e Bashkisë Tiranë, lidhur me kalimin në formalizim të grumbulluesve të mbetjeve të riciklueshme.
- Informacion lidhur me bazën ligjore me anë të së cilës vepron Policia Bashkiake Tiranë, për bllokimin e mjeteve të ndryshme të transportit të shtetasve të cilët transportojnë mjete të riciklueshme.

Seanca u zhvillua në datën 26.06.2020, me praninë e të dy palëve në proces: përfaqësuesit të subjektit ankues, shtetasi G. S., dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa: përfaqësuesit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, shtetasi P. H., me detyrë Specialist në Drejtorinë e Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit; përfaqësueses së Ministrisë dhe Mbrojtjes Sociale, shtetësja I. K., me detyrë Eksperte e Minoritetit Rom dhe Egjiptian; përfaqësuesit të Policisë Bashkiake Tiranë, shtetasit T. B., me detyrë Shef i Sektorit të Kontrollit të Territorit.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, u njoftuan palët se seanca dëgjimore do të rregjistrohej dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, palët i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Përfaqësuesi i Policisë Bashkisë Tiranë ndër të tjera, i qëndroi parashtrimeve të dhëna gjatë procedurës hetimore, si dhe theksoi faktin se Policia Bashkiake Tiranë lidhur me hapësirat publike ka një procedurë standarde të përcaktuar në aktet e miratuara nga Këshilli Bashkiak Tiranë, ndërsa sa i përket procedurave që ndiqen në rastet e bllokimit të materialeve të riciklueshme apo dërgimit të tyre në Landfilld, nuk është parashikuar një e tillë në legjislacion. Pra, nga ana e tij, u sqarua se ekziston një vakum ligjor sa i përket hapave që duhet të ndjekë

punonjësi i Policisë Bashkiake Tiranë, në rastet e identifikimit të materialit, procedurës standarde të bllokimit të materialit dhe dërgimit të tij në Landfilld.

Përfaqësuesja e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale (në vijim MSHMS), sa i përket informacionit të kërkuar nga KMD, sqaroi ndër të tjera se në vitin e parë të implementimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare është kryer një studim mbi *“Hartëzimin e aftësive, mundësive të punësimit dhe sipërmarrjes së komuniteteve romë dhe egjiptiane”*, në bashkitë e Tiranës, Durrësit, Beratit dhe Shkodrës. Sa i përket zhvillimit të programit të subvencionimit për përmirësimin ose zëvendësimin e automjeteve të modifikuara që përdoren nga romët dhe egjiptianët për transportin e mallrave, për të përmirësuar sigurinë publike dhe për të siguruar të ardhura më të qëndrueshme, u theksua se për shkak të mungesës së fondeve dhe buxhetit, nuk është realizuar një gjë e tillë. Vetëm në vitin e parë të implementimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, është buxhetuar nga donatorë zëvendësimi i mjeteve të modifikuara që përdoren nga romët dhe egjiptianët për transportin e mallrave, por nuk është vijuar më tej. Sipas përfaqësueses së MSHMS-së, nga ana e tyre dhe Bashkisë Tiranë, sipas saj, janë zhvilluar aktivitete avokuese me përfaqësues të qeverisjes vendore për të ulur taksat dhe tarifave vendore me 30 për qind për bizneset e ngritura nga romë dhe egjiptianë, si dhe gjatë viteve të implementimit të Planit të Veprimit ekzistojnë të dhëna lidhur me bizneset e ngritura nga këto minoritete kanë përfituruar ulje të taksave dhe tarifave vendore në masën 30 %.

Në përfundim, nga ana e përfaqësuesesit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, u theksua se është bërë rishikimi i rregulloreve ekzistuese për trajtimin e mbetjeve që të garantohet që të gjitha impiantet për trajtimin e tyre të jenë të rrethuara, në mënyrë që të parandalohet aktiviteti i rrezikshëm i grumbullimit të mbetjeve nga këto impiante.

III. Vlerësimi i Komisionerit, i fakteve dhe provave të grumbulluara, gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe diskriminues të pretenduar nga subjekti ankues.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësohte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Kodi i Procedurës Administrative⁶, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Policisë Bashkiake Tiranë, të cilët duhet të provonin se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkakun e pretenduar prej tij.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD⁷ në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

Më datë 03.03.2020, rreth orës 10:25, patrulla e Policisë Bashkiake Tiranë E. M. dhe B. Xh., është njoftuar nga salla operative për një ndërhyrje dhe dëmtim të kontenierëve të mbetjeve urbane në Bulevardin *“Zogu I”*. Nga ana e tyre gjatë patrullimit është konstatuar ankuesi, i cili me mjetin e modifikuar me tre rrota (karrocë), tip biçikletë, po transportonte mbetje të riciklueshme (hekur), drejtë një pike grumbullimi pranë zonës së ish Stacionit të Trenit në Tiranë. Nga ana e punonjësve të Policisë Bashkiake Tiranë, i është bllokuar mjeti biçikletë, si dhe materialet e vendosura në të, për t’i transportuar më pas drejtë Landfilldit të Tiranës.

⁶Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

⁷ Shkurtesë e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Referuar informacionit të dhënë nga përfaqësuesit e Policisë Bashkiake Tiranë gjatë trajtimit të ankesës, vërehet se ata veprojnë mbështetur në parashikimet e:

- Ligji Nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për policinë bashkiake e të komunës”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 8094, datë 21.3.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- Planit të Përbashkët “Për parandalimin e ndotjes së mjedisit, identifikimin dhe goditjen e aktivitetit të paligjshëm, të ushtruar nga individë apo subjekte private, në fushën e mbledhjes, përpunimit të materialeve të riciklueshme, në territorin e Bashkisë Tiranë”;
- Rregullore e brendshme “TIP” e Policisë së Bashkisë dhe të Komunës, miratuar me Urdhrin Nr. 18.04.2003.
- Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë Nr. 1, datë 05.02.2007 “Për rregullimin e administrimit të mbetjeve urbane dhe pastrimit të qytetit”;
- Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë Nr. 156, datë 21.12.2018 “Për përcaktimin e disa kundrvajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Tiranë”.

Në nenin 8, Ligji Nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për policinë bashkiake e të komunës”, i ndryshuar, përcaktohet se policia e bashkisë dhe e komunës ka për detyrë: “...2. Të marrë masa për ruajtjen e pasurisë së bashkisë apo të komunës si dhe të atyre që administrohen nga ana e saj...8. Të marrë masa për ruajtjen e rendit, kur ka grumbullime njerëzish, si në tregje, panairë, ceremoni publike, artistike, fetare e sportive, në kinema, teatro, pallate e salla sportive, objekte të kultit dhe në mjedise të tjera publike...”.

Në të njëjtën frymë me përcaktimin ligjor të sipërcituar qëndron edhe Rregullorja e brendshme “TIP” e Policisë së Bashkisë dhe e Komunës, së miratuar me Urdhrin Nr. 18.04.2003, të Ministrisë të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Ministrisë të Rendit Publik, në pikën 2, neni 13, ku evidentohen detyrat e punonjësve të policisë bashkiake e të komunës dhe përcaktohet se policia bashkiake ka detyrë: “...2. Të marrë masa për ruajtjen e pasurisë së bashkisë ose komunës, si dhe të atyre që administrohen nga ato...”.

Sa i përket mbetjeve urbane dhe largimin e tyre, Ligji Nr. 8094, datë 21.3.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, i ndryshuar, në nenin 2 të tij përcakton qartë se: “Të gjitha llojet e mbeturinave, sipas përcaktimit të bërë në këtë ligj, pas dorëzimit të tyre janë pronë shtetërore.”

Mbështetur në Rregulloren⁸ e Bashkisë Tiranë “Për rregullimin e administrimit të mbetjeve urbane dhe pastrimit të qytetit”, Neni 5, i kësaj rregullore, pika 28 dhe 29 e saj përcaktojnë qartësisht statusin e pronësisë së këtyre mbetjeve, si dhe domosdoshmërinë e mbrojtjes së shëndetit publik, nga keqpërdorimi i tyre.

⁸ Miratuar me Vendim Nr. 1 të Këshillit Bashkiak Tiranë, datë 05.02.2007 “Për rregullimin e administrimit të mbetjeve urbane dhe pastrimit të qytetit”

Neni 50, Kreu III, i kësaj rregullore në pikën 168 të saj, përcaktohet se: *“Është e ndaluar për qytetarët dhe këdo person të paautorizuar, të kryejë çdo lloj seleksionimi manual të mbetjeve, të dorëzuara brenda kontejnerëve, kërkim apo marrje të mbetjeve të dorëzuara në kontejnerë ose pranë impianteve të rikuperimit dhe përpunimit final”*.

Me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitutional, për parandalimin e ndotjes së mjedisit, në fushën e mbledhjeve dhe përpunimit të mbetjeve të riciklueshme etj., Bashkia Tiranë së bashku me Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, Drejtorinë Rajonale të Hetimit Tatimor Tiranë, Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Tiranë dhe Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, më datë 31.01.2017, nënshkruan Planin e Përbashkët *“Për parandalimin e ndotjes së mjedisit, identifikimin dhe goditjen e aktivitetit të paligjshëm, të ushtruar nga individë apo subjekte private, në fushën e mbledhjes, përpunimit të materialeve të riciklueshme, në territorin e Bashkisë Tiranë”*.

Referuar përcaktimeve të bëra në këtë Plan të Përbashkët, Policia Bashkiake Tiranë, është përcaktuar përgjegjëse veç të tjerash të organizojë kontrolle të territorit, për identifikimin, kapjen në flagrancë të personave, që dëmtojnë, apo vjedhin kontenierët, mbetjet e riciklueshme që ndodhen në to, duke marrë masa administrative me gjobë, bllokime të materialeve, si dhe për rastet e përsëritura, të bëhen kallëzime penale, pranë Komisariateve të Policisë, për veprat penale të konstatuara. Gjithashtu, Policia Bashkiake, sipas këtij plani, ka detyrimin të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Punëve Publike, Drejtorinë Nr. 1, Nr. 2, të Punëtorëve të Qytetit, Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit, Drejtorinë e Pastrimit të qytetit, Drejtori të cilat do të vendosin në dispozicion mjete e punonjës, për transportimin në landfill të materialeve të riciklueshme që do të bllokohen.

Këshilli Bashkiak Tiranë me Vendim Nr. 156, datë 21.12.2018 *“Për përcaktimin e disa kundrvajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Tiranë”*, në nenin 11 të tij ka parashikuar kundërvajtjet administrative në fushën e mjedisit, ku në pikën 1, ka sanksionuar se: *“Për aq sa nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e mjedisit, këto veprime: ... m. Kryerja e selektimit manual, kërkimit apo marrje të mbetjeve të dorëzuara në kontejnerë, etj. nga persona të paautorizuar... o. Hedhja, mbledhja dhe grumbullimi i materialeve, hekurishte apo çdo lloj mbetjeje dhe/ose të riciklueshme, në territore/hapësira publike apo dhe ambiente private që nuk janë miratuar nga Bashkia e Tiranës për këtë qëllim...”*.

Në pikën 2 të nenit 21 të Vendimit të Këshillit Bashkiak të sipërcituar, parashikohet se: *“Kundërvajtjet administrative, sipas këtij vendimi, konstatohen dhe shqyrtohen gjatë veprimtarisë rutinë të ushtrimit të veprimtarisë së tyre ose sipas sinjalizimeve apo ankimeve të individëve dhe qytetarëve të ndryshëm.”*

Gjithashtu, në nenin 22, të VKB-së Nr. 156, datë 21.12.2018 “Për përcaktimin e disa kundravajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Tiranë”, përcaktohet se: “1. Struktura konstatuese konstaton kundërvajtjen dhe e shqyrton atë menjëherë në vendin e kryerjes së saj. 2. Konstatimi dhe shqyrtimi i një kundërvajtje pasqyrohet në procesverbalin e kundërvajtjes, i cili përfshin, dënimin administrativ që jepet dhe sipas rastit shpërblimi dhe përlllogaritja e dëmit të shkaktuar. Procesverbali është akt administrativ.”

Lidhur me bllokimin e mjeteve të transportit të mbetjeve të riciklueshme në nenin 14, të VKB-së Nr. 156, datë 21.12.2018 “Për përcaktimin e disa kundravajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Tiranë”, sanksionohet se: “Përveç sanksionit administrativ të vendosur nga strukturat konstatuese për secilën nga kundërvajtjet e parashikuara në këtë vendim, kundërvajtësit i nënshtrohen edhe konfiskimit të sendeve/mallrave që kanë shërbyer apo që ishin caktuar për të shërbyer si mjete për kryerjen e kundërvajtjes administrative të parashikuara në këtë vendim.”

Ndërsa në Nenin 15, ku parashikohen sanksionet dhe aktet administrative, përcaktohet se:

“1. Sanksionet/ Aktet administrative për kundërvajtjet e parashikuara në këtë vendim janë:

a. Paralajmërimi me shkrim/ Akt Konstatimi;

b. Proces verbal për kundërvajtjet administrative, ku sanksionohet masa e gjobës.

2. Sanksioni “paralajmërim me shkrim” është akti i konstatimit është akt administrativ që ka për qëllim këshillimin, paralajmërimin dhe lënien e detyrës për kundërvajtësit, që jepet për një shkeljet të një rëndësie të vogël dhe/apo kur ekzistojnë rrethanat lehtësuese.

3. Në rast përsëritjeje të kryerjes të së njëjtës kundërvajtje apo të një kundërvajtje administrative tjetër sipas këtij vendimi apo legjislacionit në fuqi, jepet sanksioni administrativ me gjobë.”

Përsa më lart dhe referuar parashikimeve të legjislacionit të sipërcituar, Policia Bashkiake Tiranë është përgjegjëse dhe ka kompetencë në kontrollin e territorit, si dhe ndalimin e personave që marrin mbetje urbane nga kontenierë apo transportojnë ato me mjete të ndryshme transporti. Sa i përket procedurave që duhet të ndjekin punonjësit e Policisë Bashkiake Tiranë, në rast të konstatimit të personave të cilët transportojnë apo marrin mbetje të riciklueshme në kontenierët e tyre, nuk konstatohet të jetë e mirëpërcaktuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak të sipërcituar apo në ndonjë akt tjetër ligjor. Gjithashtu, një fakt të tillë e pohoi edhe përfaqësuesi i Policisë Bashkiake Tiranë, gjatë procedurave hetimore të shqyrtimit të ankesës.

Në rastin konkret, referuar në pamjet filmike⁹ të publikuara në rrjetet sociale dhe në Raportin e Shërbimit të mbajtur nga punonjësit e Policisë Bashkiake, ata pasi janë vënë në dijeni për ndërhyrje në kontenierët e Bashkisë Tiranë dhe transportimin e mbetjeve të riciklueshme, kanë nisur kontrollin e territorit ku është raportuar ngjarja. Gjatë patrullimit kanë konstatuar ankuesin duke transportuar mbetje të riciklueshme në Bulevardin “Zogu I”, me mjetin biçikletë të modifikuar. Pas ndalimit të ankuesit, nga ana e punonjësve të Policisë Bashkiake është njoftuar

⁹ <https://www.facebook.com/InFormim.al/videos/484885515732774/>

Drejtoria Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit të cilët kanë ardhur në ndihmë të tyre, duke marrë dhe transportuar drejtë Landfillit të Tiranës, materialet e riciklueshme së bashku me biçikletën e modifikuar.

Në nenin 22, të VKB-së Nr. 156, datë 21.12.2018 “Për përcaktimin e disa kundrvajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Tiranë”, pika 5, përcaktohet se: “Një kopje e procesverbalit i njoftohet kundërvajtësit nëpërmjet dorëzimit në vend. Në rastet kur kundërvajtësi refuzon të marrë kopjen e procesverbalit, ai konsiderohet i njoftuar. Në rastet kur kundërvajtësi nuk është i pranishëm, procesverbali njoftohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.”

Nga informacioni i vënë në dispozicion nga palët dhe provat e administruara, punonjësit e Policisë Bashkiake, pasi kanë kryer procedurat e bllokimit të mbetjeve të riciklueshme dhe mjetin e transportit të tyre, kanë përpiluar një Raport Shërbimi për të evidentuar ngjarjen e ndodhur, por pa vënë në dispozicion të ankuesit asnjë dokumentacion apo akt administrativ, siç parashikohet në VKB-në Nr. 156, datë 21.12.2018, të Këshillit Bashkiak Tiranë. Sipas këtij vendimi të Këshillit Bashkiak Tiranë, kundërvajtësit i nënshtrohen edhe konfiskimit të sendeve/mallrave që kanë shërbyer apo që ishin caktuar për të shërbyer si mjete për kryerjen e kundërvajtjes administrative të parashikuar në këtë vendim, në rastin kur ndaj tyre është marrë një masë administrative.

Në rastin konkret, ky veprim i punonjësve të Policisë Bashkiake, është justifikuar nga ana e drejtuesve të tyre me argumentin se, ankuesi është këshilluar për të mos vijuar me masë administrative rënduese për të, duke iu referuar rrethanave lehtësuese të parashikuara në nenin 19, të VKB-së Nr. 156, datë 21.12.2018, ku sanksionohet se:

1. *Lehtësojnë sanksionin administrativ këto rrethana:*
 - a. *kundërvajtësi shpreh pendesë për veprimin e kryer;*
 - b. *kundërvajtësi ka eliminuar vullnetarisht pasojat e ardhura nga shkelja e kryer, ka kompensuar humbjen ose eliminuar dënim e kryer;*
 - c. *kundërvajtja është kryer për shkak të rrethanave të rënda personale ose familjare;*
 - d. *kundërvajtja është kryer nga një grua shtatzënë.*
2. *Kur konstatohet se kundërvajtja administrative është kryer në rrethanat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, jepet dënimi administrativ me paralajmërim ose dënimi administrativ në minimum të masës së gjobës së parashikuar për atë kundërvajtje.”*

Pavarësisht faktit të sipërcituar, bllokimi i mjetit të transportit nga ana e punonjësve të Policisë Bashkiake Tiranë, pa vënë në dispozicion të ankuesit asnjë dokumentacion apo akt administrativ, është në shkelje të procedurave të parashikuara në VKB-në Nr. 156, datë 21.12.2018.

Mbështetur në informacionin e dhënë dhe provat e vëna në dispozicion nga ana e përfaqësuesve të Policisë Bashkiake Tiranë, strukturat e Policisë Bashkiake Tiranë, veprojnë në të njëjtën mënyrë si në rastin e ankuesit me çdo qytetarë. Në mbështetje të këtij qëndrimi, Policia Bashkiake, vuri në dispozicion të Komisionerit dokumentacionin e dy rasteve të tjera, ku ishte konstatuar ndërhyrja në kontenierët e mbetjeve dhe transportimi i materialeve të riciklueshme. Në të dy rastet, Policia Bashkiake, kishte vepruar në të njëjtën mënyrë, duke bllokuar mjetet me të cilat bëhej transportimi dhe mbetjet e riciklueshme, si dhe kishte depozituar ndaj tyre kallëzim penal pranë organeve përkatëse të Policisë së Shtetit, për veprën penale të vjedhjes të parashikuar në nenin 134, Ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995 *“Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, ku sanksionohet se: *“Vjedhja e pasurisë dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet. Po kjo veprë, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet. E njëjta veprë, kur ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.”*

Përsa më lart, Komisioneri konstaton se, Policia Bashkiake Tiranë, pavarësisht faktit që ndaj ankuesit nuk ka marrë masa administrative apo nuk ka bërë kallëzim penal, bllokimi i mjetit tip biçikletë (tre rotak), është bërë i pa mbështetur në asnjë akt ligjor apo nënligjor. Gjithashtu, interpretimi i bërë nga ana e përfaqësuesve të Policisë Bashkiake se bllokimi i mjetit me të cilin ankuesi po transportonte mbetjet e riciklueshme është bërë për shkak se nuk kishte asnjë dokument mbi pronësinë e tij, nuk mbështetet në asnjë akt ligjor apo nënligjor. Ligji i posaçëm Nr. 8224, datë 15.05.1997 *“Për policinë bashkiake e të komunës”*, i ndryshuar, apo edhe aktet e tjera të sipërcituara, nuk i japin Policisë Bashkiake të drejtën apo tagrin për të bllokuar apo konfiskuar mjetin e ankuesit, pa e shoqëruar atë me një dokument apo akt konstatimi. Në këtë rast, Komisioneri konstaton se veprimet e kryera nga ana e Punonjësve të Policisë Bashkiake Tiranë, nuk kanë qënë në mbështetje me parashikimet ligjore të sipërcituara.

Në analizë të informacionit të sipërcituar, Komisioneri vëren se paligjshmëria e veprimeve dhe mosveprimeve të Policisë Bashkiake Tiranë, duke bërë bllokimin e mjetit me të cilin ankuesi po transportonte mbetjet e riciklueshme, si dhe pa e shoqëruar këtë veprim me ndonjë akt konstatimi apo dokument tjetër, për të cilin ankuesi duhet të ishte vënë në dijeni, kanë bërë që ai dhe të gjithë personat që ndodhen në kushte të njëjta me të, ti mohohet e drejta e ankimit të veprimeve të Policisë Bashkiake Tiranë. Pra në këto kushte, pavarësisht faktit që procedura e ndjekur nga ana e Policisë Bashkiake Tiranë është e njëjtë si me ankuesin, ajo është e pa mbështetur dhe në interpretim të gabuar të VKB-së Nr. 156, datë 21.12.2018. Me anë të këtij veprimi Policia Bashkiake Tiranë i cënon çdo qytetari që ndodhet në kushtet e ankuesit, të drejtën për tu ankuar dhe kërkuar nga organet publike përgjegjëse këtë të drejtë.

Në përfundim, Komisioneri identifikoi se mungesa e një procedure standarde e përcaktuar në legjislacion dhe paligjshmëria e veprimeve të kryera nga ana e Policisë Bashkiake Tiranë vendosin ankuesin në kushte të pafavorshme dhe të pa justifikuar objektivisht nga një synim i ligjshëm.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2¹⁰ të ligjit Nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me parashikimet ligjore, në kushtet kur mungon krahasuesi.

Gjithashtu, diskriminimi i tërthortë¹¹, i cili ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.

¹⁰ Neni 2: *“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”*

¹¹ Nene 3, pika 3 e Ligjit “Për Mbrojtjen nga Doiskriminimi”, parashikon: *“Diskriminim i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.”*

Ankuesi pretendon se është trajtuar në mënyrë diskriminuese dhe të pabarabartë, nga ana e Policisë Bashkiake Tiranë për shkak të racës, etnisë dhe gjendjes ekonomike, shkaqe të cilat janë parashikuar në nenin 1 të Ligjit Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Gjatë trajtimit të ankesës së A. C., u administruan prova dhe argumenta se ankuesi disponon shkaqet e mbrojtura të racës, etnisë¹² dhe gjendjes ekonomike.

C. Lidhja e trajtimit të pabarabartë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe se veprimet e ndërmarra nga ana e Policisë Bashkiake Tiranë janë bërë pa shkaqe të arsyeshme dhe objektive.

Gjatë hetimit administrativ të kryer, lidhur me shqyrtimin e ankesës së shtetasit A. C., Komisioneri identifikoi se mungesa e një procedure standarde e përcaktuar në legjislacion dhe paligjshmëria e veprimeve të kryera nga ana e Policisë Bashkiake Tiranë kanë vendosur ankuesin në kushte të pafavorshme dhe të pa justifikuar objektivisht nga një synim i ligjshëm

Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

Dinjiteti i njeriut është një vlerë themelore kushtetuese¹³. Një shoqëri demokratike, që bazohet në dinjitetin e njeriut dhe parimin e barazisë së gëzimit të të drejtave themelore nga të gjithë individët, duhet të garantojë plotësimin e nevojave bazike jetësore për të gjithë. Çdo individ është pjesë e një komuniteti shoqëror të caktuar dhe në këtë kontekst interpretohet edhe dinjiteti i njeriut, si një garanci themelore.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të

¹² Referuar Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës. ECRI Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 “Diskriminim racial është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preference që bazohet se shkaqe si raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia ose origjina etnike ose kombëtare, justifikon përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e superioritetit të një personi ose një grupi personash”.

¹³Në Preambulën e Kushtetutës deklorohet: “Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojtë”.

Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij.

Neni 14, i KEDNJ, “Ndalimi i diskriminimit”, përcakton se: “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër*”.

Në çështjen Thlimmenos kundër Greqisë¹⁴, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka mbajtur qëndrimin se: “*...kemi një diskriminim kur shteti pa një argumentim objektiv dhe racional e refuzon trajtimin e diferencuar të personave, situata e të cilëve është tepër e ndryshme...*”.

Në interpretim të çështjes së sipërcituar, GJEDNJ përcakton se Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila është pjesë e legjislacionit të brendshëm¹⁵ dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në mbrojtjen nga diskriminimi përfshin jo vetëm detyrimin e trajtimit të barabartë të personave në situata të njëjta, por dhe trajtimin ndryshe të personave në situata të ndryshme.

Si dhe në nenin¹⁶ 6, pika 1 të Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, parashikohet se: “*Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.*”

GJEDNJ-ja ka theksuar se “*e drejta për të mos u diskriminuar në gëzimin e të drejtave të garantuara në KEDNJ po ashtu është shkelur kur shtetet ... nuk i trajtojnë ndryshe personat situata e të cilave janë dukshëm të ndryshme.*”¹⁷ Në mënyrë të ngjashme, direktivat e BE-së për mos-diskriminim parashikojnë shprehimisht mundësinë e veprimit pozitiv, ku thuhet: “*Me synimin për të siguruar barazi të plotë në praktikë, parimi i trajtimit të barabartë nuk do të pengojë asnjë Shtet Anëtar të mbajë ose të miratojë masa specifike për të parandaluar ose të kompensojë disavantazhet e lidhura me (një shkak të mbrojtur*¹⁸).

¹⁴Thlimmenos kundër Greqisë, Kërkesa nr. 34369/97, vendimi me datë 06.04.2000.

¹⁵Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, hyrë në fuqi në datë 02.08.1996) dhe jurisprudenca e GJEDNJ janë të detyrueshme për tu zbatuar bazuar në nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

¹⁶Neni 6, *Trajtimi i ndryshëm i përligjur*

¹⁷ECtHR, *Thlimmenos v. Greece* [GC] (No. 34369/97), 6 April 2000, para. 44. Similarly, ECtHR, *Pretty v. UK* (No. 2346/02), 29 April 2002, para. 88.

¹⁸Racial Equality Directive, Article 5; Employment Equality Directive, Article 7; Gender Goods and Services Directive, Article 6; and also ëith a slightly different formulation: Gender Equality Directive (Recast), Article 3.

Lejueshmëria e marrjes së masave pozitive në favor të grupeve të pafavorizuara përforcohet më tej nga udhëzimet e lëshuara nga disa prej organeve monitoruese përgjegjëse për interpretimin e traktateve të drejtave të njeriut të OKB-së. Këto organe kanë theksuar që masat e tilla duhet të jenë të përkohshme në natyrë, dhe jo të shtrihen në kohë apo hapësirë përtej asaj që është e nevojshme për të adresuar pabarazinë në fjalë.¹⁹ Sipas Komitetit të OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit Racor, në mënyrë që të jenë të lejueshme këto masa duhet të kenë si qëllim vetëm eliminimin e pabarazive ekzistuese dhe parandalimin e disbalancave të ardhshme.²⁰ Komisioni i OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave thekson se '*masa speciale të përkohshme*' mund të përfshijnë "*trajtim preferencial; rekrutimin, punësimin dhe promovimin; qëllimet numerike të lidhura me kornizat kohore; dhe sistemet e kuotave*".²¹

Gjykatat kanë tentuar të trajtojnë diskriminimin në këtë kontekst jo si një formë e veçantë e diskriminimit në vetvete, por si një përjashtim nga ndalimi i diskriminimit. Me fjalë të tjera, gjykatat pranojnë se ka ndodhur trajtimi i ndryshëm, por që mund të justifikohet në interes të korrigjimit të një disavantazh të mëparshëm, siç është nën-përfaqësimi në vendin e punës të grupeve të veçanta.²²

Kjo është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së. Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 "*Për mbrojtje nga diskriminimi*", është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi apo një grupi personash, mund të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

Ligji "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*", neni 3/1, parashikon se: "*Diskriminim*" është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi".

Neni 3/3 i LMD ka sanksionuar se: "*Diskriminim i tërthortë*" është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose

¹⁹ Handbook on European non-discrimination law fq.38

²⁰ UN Committee on the Elimination of Racial Discrimination, 'General Recommendation No. 32: The Meaning and Scope of Special Measures in the International Convention on the Elimination of All Forms of Racial Discrimination' UN Doc. CERD/C/GC/32, 24 September 2009, paras. 21-26.

²¹ UN Committee on the Elimination of Discrimination Against Women, 'General Recommendation No. 25: Article 4, para. 1 of the Convention (temporary special measures)' UN Doc. A/59/38 (supp), 18 March 2004, para. 22.

²² Handbook on European non-discrimination law fq.38

nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë”

Neni 7, pika 1, e LMD parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

Neni 11, i LMD-së ka parashikuar dhe mundësinë e ndërmarrjes së një sërë masash pozitive, duke sanksionuar se: *“Masa e përkohshme, e veçantë që synon përshtetimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak të përmendur në nenin 1, të këtij ligji, konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim, sipas këtij ligji. Kjo masë ndërpritet sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta”.*

Në çështjen Thlimmenos kundër Greqisë²³, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka mbajtur qëndrimin se: *“.....kemi një diskriminim kur shteti pa një argumentim objektiv dhe racional e refuzon trajtimin e diferencuar të personave, situata e të cilëve është tepër e ndryshme.....”.*

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka theksuar vazhdimisht se mbrojtja e shtresave në nevojë dhe gëzimi i të drejtave të tyre në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim duhet të jetë një ndër elementët kryesor i cili duhet të mbahet në konsideratë nga ana e institucioneve të cilët kanë rol të drejtëpërdrejtë në përmirësimin e kushteve të jetesës apo integrimin e këtij komuniteti në shoqëri. Komuniteti rom dhe egjiptian në Shqipëri përballet vazhdimisht me situata shumë të vështira për sa i përket çështjes së punësimit, çështje kjo e ngritur dhe nga Komisioni Evropian në Raportin e Progresit 2019, në të cilin evidentohet se: *“Pjesëmarrja e përgjithshme e punësimit dhe fuqisë punëtore tek komuniteti Rom mbeten shumë e ulët (mbi 56% e romëve në moshë pune janë të papunë). Punësimi informal midis romëve përbën 62% të punësuarve të komunitetit rom”²⁴.*

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), i themeluar nga Këshilli i Evropës, është organ i pavarur monitorimi për të drejtat e njeriut i specializuar në çështjet e lidhura me luftën kundër racizmit, diskriminimit (për shkak të “racës”, origjinës etnike/kombëtare, ngjyrës, shtetësisë, fesë, gjuhës, orientimit seksual dhe identitetit gjinor), ksenofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës. Në Raportin²⁵ e ECRI-t për Shqipërinë, Cikli i gjashtë monitorues, theksohet se: *“Situata e romëve dhe egjiptianëve në fushën e punësimit dhe*

²³ Thlimmenos kundër Greqisë, Kërkesa nr. 34369/97, vendimi me datë 06.04.2000.

²⁴ Progres Raporti 2019, fq. 31, përkthim i Komisionerit.

²⁵ Miratuar më 7 prill 2020

punës vazhdon të karakterizohet nga nivele të larta papunësie dhe/ose aktivitete në sektorin informal të punës, të cilat rrallë ofrojnë një mundësi për të fituar të ardhura të përshtatshme. Romët janë akoma shpesh të vetëpunësuar, kryesisht në profesione të profileve të ulëta, siç është mbledhja e hedhurinave metalike ose tregtia e vogël e dorës së dytë. Egjiptianët janë të përfshirë më shpesh në sektorin e shërbimeve, kujdesin shtëpiak dhe punën e ndërtimit. Plani Kombëtar i Veprimit (2016-2020) përmban një qëllim ambicioz për të siguruar mundësi të barabarta të punësimit formal për romët dhe egjiptianët: 80% më shumë burra dhe gra romë dhe egjiptianë që marrin pjesë në trajnime profesionale dhe programe aktive të punësimit duhet të integrohen në tregun e punës deri në vitin 2020. Sidoqoftë, për vitin 2018, vlerësohet se mbi 56% e romëve në moshë pune ishin të papunë, me punë joformale që llogaritin rreth 62% të aktivitetit të përgjithshëm ekonomik rom.”

Në përfundim të Raportit të ECRI-t për Shqipërinë, ku analizohet punësimi i komunitetit rom dhe atij egjiptian, rekomandohet se: “... autoritetet të zgjerojnë më tej aktivitetet e formimit profesional dhe programet aktive të punësimit për romët dhe egjiptianët, duke përfshirë edhe ata që përfunduan vetëm arsimin fillor, ose që nuk kanë fare arsim formal, si dhe ata që ndoqën shkollën, por mbetën analfabetë. Për më tepër, romët dhe egjiptianët që nuk janë regjistruar si të papunë duhet gjithashtu të inkurajohen në mënyrë aktive që të marrin pjesë në këto aktivitete, përmes një bashkëpunimi të ngushtë me komunitetet vendore.”

Gjithashtu, gjendja e vështirë e komunitetit rom dhe egjiptian njihet dhe nga qeveria e Republikës së Shqipërisë, e cila me VKM nr. 1072, datë 23.12.2015 ka miratuar “Planin Kombëtar të veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020” në të cilën theksohet se: “Romët dhe egjiptianët përballen me barriera të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në aksesin e shërbimeve publike, të cilat lindin nga kriteret e pranueshmërisë që ata nuk mund t’i plotësojnë, nga mungesa e informacionit ose nga moskuptimi i procedurave administrative, si dhe nga stigmatizimi dhe diskriminimi i vazhdueshëm nga pjesa tjetër e popullatës. Përjashtimi afatgjatë ka ndikuar në kushtet e jetesës së romëve dhe egjiptianëve, në trajtimin nga pjesa tjetër e popullatës dhe në marrëdhënien me institucionet shtetërore. Studimet tregojnë se niveli i varfërisë në radhët e komunitetit rom është dy herë më i lartë se në pjesën tjetër të popullatës, ndërsa niveli i papunësisë është tre herë më i lartë se mesatarja. Për shkak të periudhave të gjata të papunësisë dhe angazhimit të shpeshtë në punë informale dhe me pagë të ulët, familjet rome preken nga varfëria mbi dy herë më shumë sesa familjet jo-rome që jetojnë në afërsi të tyre. Romët që arrijnë të gjejnë punë merren kryesisht me tregti të vogla të dorës së dytë dhe mbledhjen e mbetjeve të riciklueshme²⁶”.

²⁶ Statistikat për komunitetin rom dhe egjiptianët i referohen: “Planit kombëtar të veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020” miratuar me VKM nr.1072, datë 23.12.2015, fq. 4, 11 dhe

Në këtë kuptim, Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, i miratuar me VKM nr. 1072 datë 23.12.2015, vjen si një dokument i rëndësishëm i Qeverisë Shqiptare. Ai është tërësisht i mbështetur, jo vetëm në parimet bazë të Kushtetutës së Shqipërisë, por edhe në parimet themelore të antidiskriminimit të të gjitha Konventave Ndërkombëtare. Ky Plan, përfshin politika specifike dhe masa konkrete, që institucionet përgjegjëse do të ndërmarrin në realizimin e objektivave, në sektorët respektivë dhe programet publike, që synojnë të përmirësojnë jetesën e romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri. Mbrojtja sociale është një nga mekanizmat kryesore për zbutjen e varfërisë e përjashtimit social.

Në kuadër të procesit të integritit të Shqipërisë në BE, qeveria shqiptare ka miratuar tashmë disa dokumenta, siç janë Plani Kombëtar i Integritit European 2015-2020, Udhërrëfyeni për plotësimin e 5 Prioriteteve, që përcaktojnë masa konkrete për realizimin e këtij procesi. Pesë prioritetet kyçe që rezultojnë nga dialogu politik i nivelit të lartë midis qeverisë dhe BE-së përfshijnë, *“masa efikase për forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke përfshirë romët dhe politikat antidiskriminuese”*. Përmbushja e Prioritetit 5 në Udhërrëfyenin e Qeverisë, orienton marrjen e masave në shumë fusha të politikave specifike për Romët/Egjiptianët si: rregjistrimi civil, aksesin në drejtësi, arsimi, dialogu ndërkulturor, punësimi dhe përmirësimi i aftësive, kujdesi shëndetsor, strehimi dhe integrimi urban dhe mbrojtja sociale. Janë pikërisht këto fusha që kanë orientuar objektivat kryesore të përcaktuara në këtë dokument. Gjithashtu duke marrë parasysh angazhimet e përshkruara në dokumentin Udhërrëfyeni Plani i Veprimit jep një listë më të detajuar të aktiviteteve që do të zbatoheshin gjatë periudhës 2016-2020²⁷. Ndër të tjera, Plani i Veprimit trajton nevojat në një sërë fushash kyçe përfshirë: arsimin dhe promovimin e dialogut ndërkulturor, shëndetësinë, strehimin dhe integrimin urban, punësimin dhe arsimin e aftësimin profesional, mbrojtjen sociale, regjistrimin civil dhe aksesin në sistemin e drejtësisë, me synim nxitjen e integritit në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Sipas Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, njësitë e qeverisjes vendore duhet të krijojnë mundësinë për integrimin e komuniteteve romë dhe egjiptiane, në integrimin e anëtarëve të të dy komuniteteve në jetën sociale dhe ekonomike në nivel lokal.

Gjithashtu, Bashkia Tiranë në vitin 2017, ka hartuar Planin për Zhvillimin e Komunitetit Lokal Rom dhe Egjiptian 2017-2020, si një instrument planifikimi dhe menaxhimi që synon të adresojë në terma afatshkurtër sfidat me të cilat përballen të dy komunitetet duke synuar në arritjen e një vizioni që lidhet me një shkallë më të lartë integritit të anëtarëve të të dy komuniteteve në jetën sociale dhe ekonomike në nivel lokal.

Plani i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës fokusohet në trajtimin e gjashtë sfidave të identifikuara edhe në Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, të lidhura ngushtë me kontekstin vendor. Ky plan zhvillimi është

²⁷ Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, fq. 1, 2

hartuar me synimin që të shërbejë si instrument për orientimin e përpjekjeve ndërsektoriale dhe shumëaktorëshe në lidhje me integrimin social dhe ekonomik të dy komuniteteve në Bashkinë e Tiranës. Njohja e mirë e potencialeve dhe sfidave me të cilat përballen dy komunitetet në 6 fushat prioritare: regjistrimi civil dhe aksesimi në sistemin e drejtësisë, arsimimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor, kujdesi shëndetësor, punësimi dhe formimi profesional, strehimi dhe integrimi urban, si dhe mbrojtja sociale, arrin të mbulojë dhe adresojë gamën e gjerë të problematikave shumëdimensionale të dy komuniteteve.²⁸

Nga një analizë të Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020 dhe Planit të Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës 2017-2020, evidentohet se një ndër konstatimet e bëra në këto dokumenta është niveli i arsimimit të popullsisë rome, dhe në një masë më të vogël egjiptiane, është shumë më i ulët se i banorëve të tjerë. Varfëria dhe rëndësia e sigurimit të nevojave bazë, ul ndjeshëm interesin e romëve dhe egjiptianëve për të ndjekur shkollat e arsimit profesional, kurset e formimit profesional apo përfshirjen në programe punësimi, si dhe i detyron ata të gjejnë zgjidhje alternative punësimi që shpesh janë informale. Sektorët informalë, si p.sh. mbledhja individuale e mbetjeve të riciklueshme, tregtimi i mallrave të përdorura apo aktivitetet e tjera.²⁹

Në kapitullin III, të Planit të Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë Tiranë, si një ndër qëllimet strategjike dhe objektivat sipas fushave prioritare janë: “...*Rritja e qëndrueshmërisë në punët formale të anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian; Krijimi i vendeve të reja të punës.*”³⁰

Gjithashtu, KMD shpreh mirëkuptimin e tij që informaliteti është paligjshmëri dhe për rrjedhojë krijon padijeni dhe probleme sociale dhe ekonomike në vendin tonë. Nga ana tjetër ai është një realitet dhe prek shumë qytetarë në Republikën e Shqipërisë, të cilët ndodhen në pamundësi për të siguruar mjetet e tyre thelbësore të jetesës. Në këtë kuptim, Bashkia Tiranë dhe Policia Bashkiake Tiranë, duhet të mbanin parasysh faktin që, mbledhja e mbetjeve të riciklueshme, nga ana e shtresave në nevojë, është një nga mënyrat me të cilat ata arrijnë të sigurojnë të ardhura dhe mjetet e jetesës, duke rrezikuar shëndetin.

Përsa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, thekson faktin se Bashkia Tiranë dhe Policia Bashkiake Tiranë, gjatë zbatimit të detyrave dhe kompetencave të tyre, duhet të merrnin në konsideratë gjendjen social-ekonomike të shtresave në nevojë, të cilat janë të detyruara që për shkak të gjendjes së tyre ekonomike të përdorin mbledhjen e mbetjeve urbane për të siguruar mjetet e jetesës. Institucioni i Bashkisë Tiranë, nuk arriti të provonte para Komisionerit se ka bërë përpjekjet e duhura dhe të domosdoshme për rregullimin e kësaj

²⁸ Marrë nga Plani i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian 2017-2020, i Bashkisë Tiranë

²⁹ Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, fq. 28

³⁰ Plani i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, faqja 79.

situatë, në mënyrë që grumbulluesit e mbetjeve të riciklueshme të formalizoheshin dhe të mos rrezikonin shëndetin për të siguruar mjetet e tyre të jetesës.

Mbështetur në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, rekomandimet e dhëna nga përfaqësues të partnerëve dhe institucioneve ndërkombëtare në mbrojtje të të drejtave të njeriut, si dhe referuar të dhënave të grumbulluara nga monitorimet në kuadër të Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, është konstatuar se niveli i varfërisë në radhët e komunitetit rom është dy herë më i lartë se në pjesën tjetër të popullatës, ndërsa niveli i papunësisë është tre herë më i lartë se mesatarja. Romët që arrijnë të gjejnë punë merren kryesisht me tregti të vogla të dorës së dytë dhe mbledhjen e mbetjeve të riciklueshme. Pra, niveli i varfërisë dhe kushtet ekonomike të minoritetit rom dhe atij egjiptian, janë fakte të njohura dhe publike tashmë.

Në analizë të informacionit dhe dokumentacionit të administruar, rezulton se pjesa më e madhe e grumbulluesve të mbetjeve të riciklueshme janë kryesisht anëtarë të komunitetit rom dhe atij egjiptian. Në këtë kuptim, mungesa e akteve ligjore apo një procedure standarde për konstatimin, bllokimin, shoqërimin e mjeteve dhe mbetjeve, si dhe veprimet e ndërmarra nga ana e Policisë Bashkiake Tiranë, bëjnë që anëtarët e këtyre dy komuniteteve, si pjesa më e madhe e grumbulluesve të mbetjeve të riciklueshme, të përballen në vijimësi me një situatë të pafavorshme si në rastin e subjektit ankues.

Nga ana e Bashkisë Tiranë nuk janë ndërmarrë hapa për hartimin e procedurës standarde, duke lënë kështu në tagrin e punonjësve të Policisë Bashkiake mënyrën e veprimit rast pas rasti për bllokimin e mjeteve dhe mbetjeve urbane.

Parimi i ndarjes së barrës së provës është konsoliduar mirë tashmë në ligjin e BE dhe KEDNJ. KEDS³¹ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të duhur.

Sa më sipër, për shkak se subjekti kundër të cilit pretendohet diskriminim posedon informacionin e nevojshëm, për të provuar të kundërtën ligji i mosdiskriminimit lejon që barra e provës të ndahet me këtë subjekt (zhvendosja e barrës së provës). Pasi personi që pretendon diskriminim krijon një prezumim të diskriminimit (diskriminimi prima facie), barra më pas kalon tek subjekti, i cili duhet të tregojë se **ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues**. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

³¹ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

Nëse diskriminuesi i pretenduar nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.³²

Sa i takon rastit në fjalë, KMD bazuar në shqyrtimin e fakteve dhe provave të ankuesit, si dhe ato që dolën nga procedura e shqyrtimit të ankesës ka arritur në përfundimin që kemi të bëjmë me një trajtim të pafavorshëm të ankuesit dhe personave që ndodhen në të njëjtat kushte me të nga ana e Bashkisë dhe Policisë Bashkiake Tiranë.

Në analizë sa më sipër Komisioneri vlerëson se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga ana e Bashkisë dhe Policisë Bashkiake Tiranë kundrejt ankuesit dhe si pasojë barra e provës bie tek këtyre subjekteve.

Në këto kushte, për të vërtetuar të kundërtën, Bashkia dhe Policia Bashkiake Tiranë duhet të përmbushnin dy kushtet e përmendura më sipër.

Në këtë këndvështrim, mungesa e masave të ndërmarra nga ana e Bashkisë Tiranë, për rregullimin e kësaj situatë, në mënyrë që grumbulluesit e mbetjeve të riciklueshme të formalizoheshin dhe të mos rrezikonin shëndetin për të siguruar mjetet e tyre të jetesës, i ka vënë në kushtet e një trajtimi të papërshtatshëm dhe degradues. Vazhdimi i kësaj situatë për vite me radhë pa ndërmarrë asnjë masë rregulluese, provon se Bashkia Tiranë përmes mosveprimit, kanë neglizhuar të përmbushin detyrimet ligjore që parashikojnë aktet përkatëse.

Gjithashtu, pavarësisht se është vënë në dijeni nga strukturat e Policisë Bashkiake për mungesën e një procedurë standarde ligjore për konstatimin, bllokimin dhe shoqërimin e mjeteve dhe mbetjeve të riciklueshme, Bashkia Tiranë nuk ka ndërmarrë asnjë hap, duke lënë kështu në tagrin e punonjësve të Policisë Bashkiake për të vepruar rast pas rasti për bllokimin e mjeteve dhe mbetjeve urbane. Fakti që nga ana e Bashkisë Tiranë, nuk është parashikuar një procedurë standarde se si veprohet në këto raste, lë hapsira që të veprohet në mënyrë arbitrare dhe i mohon qytetarëve të drejtën për të ankimuar procedurat e punonjësve të Policisë Bashkiake. Pra, subjekti ankues është vënë në pozita përjashtuese dhe diskriminuese, pikërisht për shkak të racës, etnisë dhe gjendjes së tij ekonomike, në formën e diskriminimit të tërthortë.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se:

- Nuk ekzistonte një procedurë standarde ligjore për konstatimin, bllokimin dhe shoqërimin e mjeteve dhe mbetjeve të riciklueshme, me anë të së cilës Policia Bashkiake Tiranë të veprojë për të ushtruar funksionet e saj;
- Nga ana e Bashkisë Tiranë nuk janë ndërmarrë hapa për hartimin e procedurës standarde, duke lënë kështu në tagrin e punonjësve të Policisë Bashkiake mënyrën e veprimit rast pas rasti për bllokimin e mjeteve dhe mbetjeve urbane;

³² https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-laë-2018_en.pdf, fq.232.

- Mungesa e një procedure standarde, ka përballur pikërisht anëtarët e komunitetit rom dhe atij egjiptian me situata të pafavorshme si në rastin konkret;
- Bashkia Tiranë nuk arriti të provonte se kishte ndërmarrë hapa konkret në kuadër të zbatimit të Planit Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, sa i përket formalizimit të grumbulluesve të mbetjeve të riciklueshme duke i mohuar kështu edhe mundësinë për të siguruar mjetet minimale të jetesës.

Komisioneri vlerëson se nga ana e Bashkisë dhe Policisë Bashkiake Tiranë, nuk u arrit të provohej:

1. Që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar nga ankuesi, që janë raca, etnia dhe gjendja ekonomike si dhe trajtimit të pafavorshëm nga ana e Bashkisë dhe Policisë Bashkiake Tiranë, të konstatuar edhe nga Komisioneri në këtë vendim.
2. Që për veprimet e këtij subjekti kundrejt ankuesit ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, pra që këto veprime ndiqnin një synim të ligjshëm dhe masat për arritjen e këtij synimi ishin proporcionale.

Sa më sipër Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të pafavorshëm dhe të paligjshëm nga ana e Bashkisë Tiranë dhe Policisë Bashkiake Tiranë, në formën e diskriminimit të tërthortë për shkak të racës, etnisë dhe gjendjes ekonomike.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 12, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të tërthortë, për shkak të racës, etnisë dhe gjendjes ekonomike, të shtetasit A. C. nga ana e Bashkisë Tiranë dhe Policisë Bashkiake Tiranë.
2. Referuar pikës 1 të këtij vendimi, të merren masa nga Policia Bashkiake Tiranë, për pajisjen me një akt administrativ të vlefshëm shtetasin A. C., në lidhje me sekuestron e vendosur në bazë të raportit të shërbimit të datës 03.03.2020.
3. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Bashkisë Tiranë dhe Policisë Bashkiake Tiranë, për hartimin e një procedure standarde, lidhur me konstatimin dhe bllokimin e mjeteve të transportit dhe mbetjeve të riciklueshme.
4. Të merren masa nga Bashkia Tiranë për zbatimin e Planit të Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian 2017-2020, në pjesën që parashikon mbi formalizimin e grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme.

5. Në kuadër të plotësimit të masave konkrete, në realizimin e objektivave të Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, **rekomandohet** që Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, të kryej një studim mbi situatën dhe pozicionin e grumbulluesve individualë romë dhe egjiptianë të mbetjeve të riciklueshme në Republikën e Shqipërisë.
6. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, Bashkia Tiranë dhe Policia Bashkiake Tiranë, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
7. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
8. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Raca, etnia dhe gjendja ekonomike)
(Fusha të mira dhe shërbime)